Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDFH. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse përmbush njëkohësisht dy kushtet si më poshtë si edhe nuk është i destinuar me VDFH:

- mbahet në një model biznesi i cili ka për qëllim të mbajë aktivet për të mbledhur flukset e parasë; dhe
- rrjedha e parasë, lind në data të përcaktuara, sipas kushteve kontraktuale, të cilat janë, vetëm pagesa principali dhe interesit (VPPI).

Të gjitha aktivet e tjera financiare të Fondit maten me VDFH.

Vlerësimi i modelit të biznesit
Në gjykimin e tij mbi vlerësimin e objektivave të modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv, Fondi merr parasysh të gjithë informacionin relevant mbi mënyrën se si biznesi po administrohet duke përfshirë:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit;
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e kaluara.

Fondi ka dy modele biznesi.
Modeli i biznesit mbajtje deri në mbledhje: ky model përfshin paranë dhe ekuivalentet e saj, dhe të arkëtueshme. Këto aktive financiare mbahen në mënyrë që të mblidhen flukset kontraktuale të parasë.
Model tjetër biznesi: kjo përfshin letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Këto aktive financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, mbi bazën e vlerës së drejtë, meqenëse ndodh shpesh tregtimi i tyre në treg.

Riklasifikimet
Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e tij të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Në këtë rast të gjithë aktivet financiare që ndikohen, do të riklasifikohen në datën e parë në periudhën e parë raportuese që vijon ndryshimin e modelit të biznesit.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivet financiare me VDFH
Këto aktive financiare maten më pas me vlerën e drejtë. Fitimet ose humbjet neto, duke përfshirë të ardhura ose shpenzime nga interesi, ose kurset e këmbimit, njihen në fitim humbje, në të ardhura neto nga instrumentat financiare në VDFH, në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare përfshihen në këtë kategori.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar
Këto aktive maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi njihen në të ardhura nga interesi sipas metodës së interesit efektiv, fitim humbjet nga kurset e këmbimit njihen në fitim humbje neto nga kurset e këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen në

humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje në njohjen fillestare gjithashtu njihet në fitim humbje. Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshihen në këtë kategori.

Detyrimet financiare – Klasifikimi, matja e mëpashshme dhe fitim ose humbjet
Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me kosto të amortizuar ose në VDFH. Një detyrim financiar klasifikohet si VDFH nëse ai klasifikohet si i mbajtur për tregtim, nëse ai është një derivativ ose nëse është i destinuar si i tillë në njohjen fillestare. Detyrimet financiare në VDFH maten me vlerën e drejtë dhe fitim humbjet neto, duke përfshirë edhe ndonjë interes, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Detyrime të tjera financiare maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet nga interesat dhe fitim ose humbjet nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga ç'regjistrimi njihet po ashtu në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

Detyrimet financiare me VDFH
Këto janë instrumenta financiarë të mbajtur për tregtim.

Detyrimet financiare me kosto të amortizuar
Këto janë detyrimet me Shoqërinë Administruese, Bankën Depozitare dhe detyrime të tjera.

iii. Matja e vlerës së drejtë
'Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti financiar duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Fondi mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyron rëndësinë e përdorimit të faktorëve në këto matje:

- Niveli 1: Faktorë që janë të kuotuar me çmime tregu në tregje aktive të instrumenteve identike
- Niveli 2: Faktorë të tjerë nga ato të kuotuar me çmime tregu sipas Nivelit 1, dhe që janë të vëzhgueshëm ose drejtpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve) ose jo në mënyre të drejtëpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve të përcaktuara).

- Niveli 3: Faktorë që janë të pavëzhgueshëm. Në këtë kategori përfshihen të gjithë instrumentet financiare për të cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit.

Instrumentat financiare jo me vlerë të drejtë
Instrumentat financiare që nuk maten me VDFH përfshijnë:

- Paraja dhe ekuivalentet e saj, detyrime të tjera. Këto janë aktive financiare dhe detyrime financiare afatshkurtra, vlera kontabël e të cilave është afërsisht e njejtë me vlerën e drejtë, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër si edhe cilësinë e lartë të aftësisë paguese së tyre; dhe
- Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave. Fondi lëshon dhe ripaguan në rutinën e tij kuotat e mbajtësve në një shumë që është e njejtë me pjesën e tyre në aktivet neto të Fondit në kohën që ato tërhiqen, dhe llogariten mbi bazë konsistente me atë të përdorur në pasqyrat financiare. Rrjedhimisht, vlera kontabël e aktiveve neto që i atribuohen kuotambajtësve është afërsisht e njejtë me vlerën e drejtë.

iv. Matja e vlerës së amortizuar

"Kostoja e amortizuar" e aktiveve financiare ose detyrimeve financiare është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare pasi janë zbritur ripagesat e principalit, ose amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës fillestare dhe vlerës në maturim, dhe për aktivet financiare të rregulluar për ndonjë zhvlerësim.

v. Zhvlerësimi

Fondi njeh një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK") për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar. Për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë të rëndësishme që prej njohjes fillestare të tij, dhe kur vlerëson HPK, Fondi merr parasysh informacionet mbështetëse dhe të arsyeshme dhe që janë relevante dhe të gatshme pa shume kosto dhe punë shtesë. Kjo përfshin analizim të informacionit cilësor dhe sasior, duke u bazuar në historikun dhe eksperiencën e Fondit si edhe duke përfshirë informacione të cilat i përkasin të ardhmes. Fondi supozon se rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyrë të rëndësishme në rast se ai shfaqet më shumë se 30 ditë në vonesë.

Fondi konsideron si aktive financiare me rrezik të ulët në rastet kur rreziku i kredisë të kundërpartisë është i listuar si BBB+ nga agjensi të mirënjohura të vlerësimit si Standard and Poor's, ose kur aktivet financiare lëshohen nga Qeveria Shqiptare ose nga Banka e Shqipërisë.

Fondi nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 30 qershor 2026.

vi. Ç'regjistrimi

Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi financiar kanë mbaruar, ose kur Fondi transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë në një transaksion në të cilin në mënyrë të qenësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar ose në të cilin Fondi as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia dhe nuk ushtron kontroll mbi aktivin financiar.

Në njohje të një aktivi financiar, ndryshimi midis vlerës së mbartur të aktivit dhe vlerës së dhënë njihet në pasqyrën e fitim humbjes.

d. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentë e saj përfshijnë mjete monetare në llogari rrjedhëse në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo më shumë se tre muaj nga data e mbajtjes të cilat mund të jenë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme në vlerën e tregut dhe që përdoren nga Fondi në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

e. Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

Të ardhura dhe shpenzime nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi efektiv llogaritet në njohjen fillestare të një instrumenti financiar si norma që skonton flukset e ardhshme të pagueshme ose të arkëtueshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në:

- vlerën bruto të aktivit financiar; ose
- vlerën me kosto të amortizuar të detyrimit financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, metoda e interesit efektiv aplikohet mbi vlerën bruto të aktivit (në rast se aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit financiar.

f. Shpenzime nga tarifa dhe komisione

Shpenzime nga tarifa dhe komisione janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

g. Tarifa për Shoqerinë Administruese

Fondi duhet ti paguajë Shoqerisë Administruese një tarifë prej 1% të aktiveve neto, e cila njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

h. Fitimi neto nga instrumentet financiare me VDFH

Fitim humbja neto nga instrumentet financiare me VDFH përfshin të gjithë ndryshimet në vlerën e drejtë të realizuara ose jo si edhe diferencat nga kursi i këmbimit si edhe të ardhurat nga interesat.

Fitim/humbjet e parealizuara njihen si ndryshimi midis kostos dhe vlerës së drejtë të një instrumenti. Kur instrumenti shitet, vlera e parealizuar e fitimit ose humbjes transferohet në fitimet ose humbjet e realizuara të periudhës.

i. Vlera neto e aktiveve të Fondit

Vlera neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

j. Tatimi mbi fitimin

Sipas sistemit tatimor në Shqipëri, Fondi është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

k. Vlera e kuotës së Fondit Albsig Standard

Vlera e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit përpjestuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlera fillestare e kuotës ka qenë e barabartë me 1.000 Lekë, në përputhje me politikën e Fondit.

l. Detyrime të shitjes së kuotave

Në momentin e kërkesës për shlyerje kuotash nga investitorët, vlera e kuotave regjistrohet si detyrim financiar dhe mbartet si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar.

m. Transaksione me palë të lidhura

Palë të lidhura me Fondin konsiderohen ato palë të cilat kanë një influencë dhe kontroll në vendimet financiare dhe operacionale të Fondit.

Palë të lidhura me Fondin janë Albsig Invest Sh.a, e cila administron Fondin, Depozitari Banka Tirana Sh.a, i cili kontrollon mirë-administrimin e Fondit, si dhe Albsig Jetë Sh.a në cilësinë e aksionarit të vetëm të Shoqërisë Administruese.

4. Administrimi i rrezikut financiar

a. Kuadri për administrimin e rrezikut financiar

Fondi investon në instrumente financiare në përputhje me strategjinë e tij të investimit. Portofoli i Fondit të investimit përfshin letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Kështu Fondi është i ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve nga instrumentet financiare:

- rreziku i kredisë;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i tregut; dhe
- rreziku operacional.

b. Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ në aktivet e Fondit.

Politika e Fondit mbi rrezikun e kredisë është minimizimi i ekspozimit të tij ndaj palëve të cilat janë të perceptuara si me rrezik të lartë, dhe të ketë marrëdhënie vetëm me palë të cilat përmbushin standardet e kredisë sipas politikës së investimit të Fondit.

Rreziku i kredisë per investimet në Bono dhe Obligacione të Qeverisë Shqiptare, lidhet ngushtësisht me aftësinë paguese të Qeverisë Shqiptare. Rreziku i kredisë tradicionalisht është vlerësuar si i ulët për letrat me vlerë të qeverisë krahasuar me letra të tjera me vlerë.

Të gjitha veprimet kryhen nëpërmjet Bankes Depozitare, e cila është e miratuar nga AMF.

Investimet e Fondit janë detajuar si më poshtë:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Bono thesari dhe Obligacione të Qeverisë[1]	260,289,941.91	256,436,726.75
VLERA KONTABËL	**260,289,941.91**	**256,436,726.75**

c. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet e tij ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme.

Politika e Fondit në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, duke përfshirë edhe shlyerjet e vlerësuara të kuotave, pa shkaktuar papranueshmëri humbje ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Fondit.

[1] Qeveria Shqiptare vlerësohet si B +, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Standard & Poor's dhe B1 e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Moody's.

Aktivet financiare të Fondit përfshijnë Bono Thesari dhe Obligacione të Qeverisë Shqiptare të mbajtura me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes dhe pesha e tyre do ndryshojë në varësi të kushteve të tregut si edhe politikës dhe strategjisë së investimit të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese sipas nenit 22, pika 2 e rregullores nr. 106, datë 30.06.2021 "Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike", e ndryshuar me Vendim Bordi nr. 186, më datë 29.09.2022, duhet të mbajë si asete likuide me cilësi të lartë (ALCL) vlerën më të madhe midis të 10% të aseteve neto të fondit, ose vlerën bruto të flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes. Asetet me likuiditet të lartë konsiderohen paraja dhe ekuivalentet e saj ose depozita me maturitet më të vogël se 7 ditë apo bono apo obligacione të Qeverisë Shqiptare që maturohen brenda 1 muaji.

Aktivet likuide të cilësisë së lartë ("ALCL")
Në përputhje me kërkesat e rregullores numër 106, datë 30 qershor 2021, ALCL të Fondit më 30 qershor 2026 janë në vlerën 15.23% të aktiveve neto, vlerë e cila është mbi minimumin e kërkuar nga rregullorja prej 10% të aktiveve neto të fondit ose vlerën bruto të flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes.

Fondi mban një nivel aktivesh likuide prej të paktën 10% të totalit të aktiveve, në para dhe ekuivalente të saj, si edhe letra me vlerë me afat të shkurtër, në varësi të kushteve të tregut dhe në përputhje me strategjinë e investimit të Fondit.

d. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut zhvillohet si pasojë e ndryshimeve në:

a) normat e interesit,
b) kurset e këmbimit.

Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së instrumentit financiar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së instrumentit financiar. Si rrjedhojë e ndryshimeve në normat e interesit investitori në periudha afatshkurtra mund të pësojë humbje të pjesshme të kapitalit. Por një veçori e e bonove dhe obligacioneve është se nëse emetuesi i tyre nuk falimenton, investitori do të sigurojë një normë kthimi të barabartë me normën e kuponit vetëm nëse ai e mban bonon apo obligacionin deri në maturim. Shoqëria Administruese, menaxhon rrezikun nga normat e interesit me anë të strategjive të menaxhimit të kohëzgjatjes (duration) duke menaxhuar "key rate duration", që do të thotë duke rritur ose zvogëluar kohëzgjatjen e tyre në varësi të kushteve të tregut dhe duke vendosur limite mbi këto "key rate durations". Kufiri i kohëzgjatjes mesatare të fondit do të jetë më e vogël ose e barabartë me 6 vjet.
Luhatjet e kursit të këmbimit sjellin luhajte të vlerës së aktiveve të konvertuar në monedhën vendase, Lek. Fondi nuk ka parashikuar që të shpërndajë aktive në monedhë të huaj.

e. Rreziku operacional

'Rreziku operacional' është rreziku i pësimit të një humbjeje direkte ose jo-direkte që mund të lindë si pasojë e një sërë shkaqesh që shoqërojnë proçese të tilla si teknologjia dhe infrastruktura që mbështet veprimtarinë e Fondit me instrumentet financiare, qoftë së brendshmi në Fond apo së jashtmi me ata që i ofrojnë shërbime Fondit, dhe nga faktorë të jashtëm të tjerë nga rreziku i kredisë, i tregut apo i

likuiditetit, të tillë si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe standardet e gjithëpranuara të sjelljes së investimeve.

Qëllimi i Fondit është të administrojë rrezikun operacional në mënyrë të tillë që të baraspeshojë kufizimet në humbje financiare dhe dëmtimit të reputacionit me arritjen e qëllimit të investimeve për të prodhuar kthim ndaj investitorëve. Aktivet e Fondit ruhen nga Banka Depozitare që është Banka e Tiranës.

Shoqëria e Administrimit të Fondit ka krijuar një sistem të kontrollit të brendshëm dhe procedurat për të parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabimet njerëzore ose të sistemit. Për shkak të proceseve joadekuate të brendshme, për shkak të gabimeve të dokumentacionit, si dhe për shkak të procedurave të tregtimit, vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Shoqëria administron Fondin përmes një sistemi operativ i cili është ndërtuar duke respektuar parimin 4 (katër) sy. Gjithashtu, Banka e Depozitarit luan një funksion kontrolli mbi aktivitetin e investimeve dhe transaksioneve me anëtarët e fondit (investimet dhe shlyerjet).

5. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj maten me koston e amortizuar në pasqyrat financiare dhe përbëhen si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Llogari rrjedhëse në bankë	8,150.14	18,245.43
Depozita me afat maturimi deri në tre muaj	42,450,000.00	34,000,000.00
Totali	**42,458,150.14**	**34,018,245.43**

Depozita afatshkurtër konsiston në një depozitë të vendosur pranë Bankës Tirana me vlerë prej 42,450,000.00 Lekë, me normë interesi prej 2,50% dhe maturim deri më 07 korrik 2026.

6. Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes

Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes përbëhen nga letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare.

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Obligacione Qeveritare	249,934,413.12	246,199,622.49
Obligacione të Shoqërive	10,355,528.79	10,237,104.26
Totali	**260,289,941.91**	**256,436,726.75**

7. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi përbëhen si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Të ardhura nga interesi i depozitave	2,907.53	2,328.77
Të ardhura nga obligacionet	5,341,274.59	4,863,650.52
Totali	**5,344,182.12**	**4,865,979.29**

8. Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese

Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese paraqet vlerën e tarifës administrimi e përllogaritur në bazë ditore të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit për periudhën 30 qershor 2026.

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	252,260.34	248,968.64
TOTALI	**252,260.34**	**248,968.64**

9. Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare

Të pagueshme në vlerën prej 32,793.84 Lekë janë detyrime ndaj Bankës Depozitare, më 30 qershor 2026.

10. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera në vlerën 96,743.82 Lekë janë detyrime ndaj AMF, detyrime ndaj Audituesit të Pavarur dhe detyrime ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve , më 30 qershor 2026.

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Detyrime ndaj Audituesit të Pavarur	77,359.40	156,001.00
Detyrime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	12,632.14	12.489,29
Detyrime ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	6,752.28	0
TOTALI	**96,743.82**	**168,490.29**

11. Të ardhura nga shitja e instrumenteve financiare neto

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Të ardhura nga shitja e Bonove të Thesarit	-	-
Të ardhura nga shitja e Obligacioneve Qeveritare	132,899.56	-
Totali	-	-
Humbje të realizuara nga obligacionet	(52,693.82)	(191,561.60)
Te ardhura nga shitja e instrumenteve financiare, neto	**80,205.74**	**(191,561.60)**

12. Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Të ardhura interesi nga letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare	6,753,284.33	11,914,271.67
Të ardhura interesi nga letrat me vlerë të Shoqërive	400,000.00	800,000.00
Të ardhura interesi nga depozitat	462,488.26	1,042,894.26
Të ardhura të tjera	4.23	3,362.95
Totali	**7,615,776.82**	**13,760,528.88**

13. Tarifa e Shoqërisë së Administrimit

Tarifa e Shoqërisë së Administrimit në vlerën prej 1,530,846.16 Lekë përfaqëson shpenzimin e ndodhur përgjatë periudhës dhe përllogaritet si 1% (në bazë vjetore) e vlerës neto të aktiveve. Ky shpenzim përllogaritet në bazë ditore.

14. Tarifa e Bankës Depozitare

Tarifa e Bankës Depozitare përbehet si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Tarifa e Bankës Depozitare	199,010.02	484,568.20
Detyrime të tjera, blerje Letra me Vlerë	16,490.00	25,358.00
TOTALI	**215,500.02**	**509,926.20**

Banka e Tiranës është banka depozitare e Fondit.

15. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera përbehen si vijon:

	30 qershor 2026	31 dhjetor 2025
Tarifa e Auditit të Pavarur	77,359.40	156,001.00
Tarifa AMF	76,823.27	142,843.53
Të tjera	2.93	5.63
Totali	**154,185.60**	**298,850.16**

16. Raporti i pozicioneve me palë të lidhura

Vlera prej 15.000.000 Lekë në pasqyrën e pozicionit me palë të lidhura tregon shumën e investuar në Fond nga Aksionari i Vetëm i Shoqërisë Administruese, Albsig Jetë Sh.a. Ndërkohë vlera prej 17,916,484.05 Lekë tregon balancën më datë 30 qershor 2026.

Përgatiti:

Irfan LAMI

Drejtor i Departamentit të Financës Albsig Sh.a

(funksion i deleguar)

Miratoi:

Elton KORBI

Administrator i Përgjithshëm Albsig Invest Sh.a

ALBSIG INVEST SHA
RRUGA E BARRIKADAVE, TIRANE - NUIS: L92208025J

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

2. Lloji dhe tiparet e fondit të investimit

Data: 30.06.2026
Emri i fondit të investimit: Fondi i Investimit Albsig Standard
Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest
Lloji i fondit të investimit: FI-B5

Tiparet e fondit të investimit:	
1	Indikatori sintentik i rrezikut = 3
2	Investon kryesisht në Bono dhe Obligacione të Shtetit Shqiptar
3	Likuiditet i lartë
4	Kohëzgjatja: Afatmesme

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

3. Asetet e vlerësuara si ALCL

Data: 30.06.2026
Emri i fondit të investimit: Fondi i Investimit Albsig Standard
Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Asetet e vlerësuara si ALCL

Nr	Lloji i asetit	Kodi ISIN	Tregu (aktiv/jo-aktiv)	Industria përkatëse e emetuesit	Rating	Vlera	Interesa të përllogaritura (lekë)
1	Cash	N/A	N/A	Sektor Bankar	N/A	8,150.14	-
2	Depozite 1 Javore	N/A	N/A	Sektor Bankar	N/A	42,452,907.53	2,907.53
3	Kupona dhe maturime	N/A	N/A	Sektor Bankar	N/A	4,394,900.00	-
Total						**46,855,957.67**	**2,907.53**

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

4. Totali I ALCL të investuara në treg Aktiv

Tregu ku është investuar	ISIN	Vlera	Konsiderimet e tregut sipas shtojcës II të rregullores nr.2, datë 27.01.2021
1			
2			
3			
4			
Totali I ALCL në treg Aktiv	-	-	-

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

5. Niveli i kërkuar i ALCL (Rezervë likuiditeti)

Përshkrimi	Vlera (Lekë)
a) 10% aseteve neto të fondit në vlerë	30,771,047.62
b) Vlera bruto e flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit	8,484,034.81
Niveli i kërkuar i ALCL	**30,771,047.62**

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

6. Mjete monetare & instrumente në mbulim të 50% të rezervës

Asete ALCL me afat maturimi deri në 7 ditë

Mjete monetare & instrumentë me afat maturimi deri në 7 ditë	Vlera (Lekë)	Në % ndaj nivelit të kërkuar të ALCL	Datë maturimi
Cash	8,150.14	0%	
Depozite 1 Javore	42,452,907.53	138%	07.07.2026
Vlera në Total	**42,461,057.67**	**138%**	

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

7. Shlyerjet Neto sipas kërkesave të pikës 3 të nenit 28, të rregullores Nr.107, datë 30.06.2021

Shlyerjet Neto, Periudha: 01.04.2026-30.06.2026			
			(Lekë)
Data	Flukse monetare dalese	Flukse monetare hyrese	Flukse monetare dalese neto
01.04.2026	-	75,000.00	75,000.00
02.04.2026	-	42,000.00	42,000.00
03.04.2026	880,138.22	27,000.00	- 853,138.22
07.04.2026	-	206,000.00	206,000.00
08.04.2026	-	170,000.00	170,000.00
09.04.2026	-	5,000.00	5,000.00
10.04.2026	-	-	-
14.04.2026	-	-	-
15.04.2026	-	1,073.42	1,073.42
16.04.2026	-	-	-
17.04.2026	-	50,000.00	50,000.00
20.04.2026	-	78,551.87	78,551.87
21.04.2026	-	50,000.00	50,000.00
22.04.2026	-	-	-
23.04.2026	-	-	-
24.04.2026	-	20,000.00	20,000.00
27.04.2026	195,713.41	2,000.00	- 193,713.41
28.04.2026	956,004.04	30,000.00	- 926,004.04
29.04.2026	-	3,410.00	3,410.00
30.04.2026	-	-	-
04.05.2026	-	74,000.00	74,000.00
05.05.2026	-	152,500.00	152,500.00
06.05.2026	585,987.76	70,000.00	- 515,987.76
07.05.2026	-	-	-
08.05.2026	-	12,000.00	12,000.00
11.05.2026	4,645,234.46	1,000.00	- 4,644,234.46
12.05.2026	-	70,000.00	70,000.00
13.05.2026	-	30,000.00	30,000.00
14.05.2026	-	1,000.00	1,000.00
15.05.2026	-	-	-
18.05.2026	-	-	-
19.05.2026	-	-	-
20.05.2026	-	1,049.99	1,049.99
21.05.2026	-	-	-
22.05.2026	-	-	-
25.05.2026	-	26,567.50	26,567.50
26.05.2026	-	-	-
28.05.2026	-	-	-
29.05.2026	-	-	-
01.06.2026	-	86,100.00	86,100.00
02.06.2026	1,036,074.09	23,250.00	- 1,012,824.09
03.06.2025	-	5,000.00	5,000.00
04.06.2026	-	51,000.00	51,000.00
05.06.2026	-	88,000.00	88,000.00
08.06.2026	-	25,850.00	25,850.00
09.06.2026	-	5,000.00	5,000.00
10.06.2026	-	-	-
11.06.2026	-	-	-
12.06.2026	-	-	-
15.06.2026	-	-	-
16.06.2026	-	-	-
17.06.2026	-	-	-
18.06.2026	14,998.14	46,139.00	31,140.86
19.06.2026	-	45,000.00	45,000.00
22.06.2026	-	15,000.00	15,000.00
23.06.2026	-	21,097.50	21,097.50
24.06.2026	-	51,040.50	51,040.50
25.06.2026	-	2,002,000.00	2,002,000.00
26.06.2026	-	-	-
29.06.2026	-	5,000.00	5,000.00
30.06.2026	-	-	-
Totali	**8,314,150.12**	**3,667,629.78**	**- 4,646,520.34**

Shtojca 8. Raport mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar në përputhje me kërkesat e rregullores nr.2, datë 27.01.2021						
Pjesa A Sipas referencave në rreg nr. 2, datë 27.01.2021	Emri i asetit	Çmimi i paguar ose i marrë për letrën me vlerë	Çmimi i tregut për letrën me vlerë/çmimi i referimit	Kotoja e transaksionit, si % ndaj vlerës së transaksionit (komision, tarifa)	Vlera e transaksionit si % ndaj vlerës neto të aseteve në momentin e transaksionit/ve	Emri i kundërpalës dhe marrëdhënia me shoqërinë administruese ose shoqërinë e
Seksioni 20/3/a transaksione blerje						
Seksioni 20/3/b transaksione shitje						
Seksioni 20/3/c transaksione blerje						
Seksioni 20/3/c transaksione shitje						
Seksioni 20/3/d transaksione blerje						
Seksioni 20/3/d transaksione shitje						
Seksioni 20/3/e transaksione blerje						
Seksioni 20/3/f transaksione në blerje						
Pjesa B	Vlera				Vlera në % e transaksioneve në total për periudhën raportuese	Lista e të gjitha kundërpalëve që zënë më shumë se 20% sipas vlerës së shitjeve dhe blerjeve
Blerje në total nga palët e lidhura						
Shitje në total nga palët e lidhura						

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

9. Të dhëna mbi investitorët e fondit të investimit

Vlera e Investuar	Numri i investitorëve
0 - 500,000 ALL	83
500,000 - 1,000,000 ALL	14
1,000,000 - 2,000,000 ALL	16
2,000,000 - 2,500,000 ALL	5
2,500,000 - 3,000,000 ALL	4
3,000,000 - 4,000,000 ALL	2
4,000,000 - 5,000,000 ALL	1
5,000,000 - 10,000,000 ALL	6
Mbi 10,000,000 ALL	4
TOTAL	**135**

Albsig Invest Sh.a
Fondi i Investimit Albsig Standard

8. Treguesit e portofolit të fondit të investimit

Vlera totale e aseteve të fondit: LEK

Struktura e aseteve	Total	Deri në 1 muaj	> 1 muaj deri 3 muaj	> 3 muaj deri 6 muaj	> 6 muaj deri 1 vit	> 1 vit deri 3 vjet	> 3 vjet deri 5 vjet	> 5 vjet deri 7 vjet	> 7 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentë	8,150.14	8,150.14	-	-	-	-	-	-	-
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Depozita bankare	42,452,907.53	42,452,907.53	-	-	-	-	-	-	-
	13.78%	13.78%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Bono thesari RSH	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Obligacione qeveritare RSH	255,260,132.14	-	-	-	-	37,158,687.30	43,662,504.87	18,707,836.73	155,731,103.24
	82.85%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	12.06%	14.17%	6.07%	50.55%
Obligacione qeveritare jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Obligacione të korporatave	10,371,084.35	-	-	-	-	10,371,084.35	-	-	-
	3.37%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	3.37%	0.00%	0.00%	0.00%
Kuota në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Asete të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Total Portofoli i Investimeve	308,092,274.17	42,461,057.67	-	-	-	47,529,771.65	43,662,504.87	18,707,836.73	155,731,103.24
	100.00%	13.78%	0.00%	0.00%	0.00%	15.43%	14.17%	6.07%	50.55%

Likuiditeti	42,461,057.67
Kthyeshmëria	4.30%
Modified Duration	4.72